

Në ujin e vluar të dhunës...

Asgjë nuk ndodh menjëherë.

Në një vaskë me ujë që nxehet gradualisht, mund të vdesësh pa e kuptuar.”

Ky përshkrim i Margaret Atwood nga “Rrëfenja e Shërbëtores” është metafora e përkryer për ciklin e dhunës ndaj grave i cili nuk është kurrë një episod i izoluar shpërthimi nga “lodhja”, “stresi”, “nervat” apo “pasioni”.

Jo! Këto janë vetëm etiketat e justifikimit të mësuara ndër vite.

Është gjithmonë më shumë se një moment, është një qasje këmbëngulëse e tinëzare, e përforcuar, vlerësuar, shpërblyer ose thjesht e neglizhuar keqas.

1 në 3 gra në nivel botëror pranojnë se kanë qenë të paktën një herë në jetë pre e dhunës fizike, seksuale apo presionit qoftë nga partneri ose një i panjohur.

Në Ballkanin tonë çdo muaj, prej 2020 janë vrarë mesatarisht 4 gra dhe me shumë se 66% e ndjejnë në lekurë kërcënimin e dhunës në familje. (RCC, Securimeter 2024)

Në Shqipëri 52.9% e grave raportojnë një ose më shumë forma të dhunës gjatë gjithë jetës së tyre. (Grevio, 2024)

Sikur të mos mjaftonin format klasike të abuzimit e dhunës, të trashëguara ndër vite në shoqërinë tonë, të rritur nën thundrën e përdhunës, kohët moderne, kohët e medias sociale dhe të lirive pa kushte e rregulla që ato kanë, na kanë sjellë një kërcënim edhe më të madh, përballë të cilit jemi të rrezikuar, absolutisht, të gjithë, gra, burra e fëmijë.

Është rreziku i homogjenitetit të dhunuesve, i jehonës që dhuna merr nga dritaret online, terreni ku anonimati bullizon me format me perverse të të shprehurit, kryesisht gratë, vajzat e të miturit duke krijuar platformën e re të krimit, kronikat e të cilit po shëmbin çdo ditë qetësinë e secilit prej nesh.

Shqipëria është vendi i parë në rajon me një sjellje paradoksale për botën online.

43% e qytetarëve e konsiderojnë të besueshëm informacionin që marrin nga mediat sociale, por ama 59,2% janë të trembur për pasojat që ky informacion ka tek fëmijët. (Balkan Barometer 2024)

Ndaj nuk më bën çudi që edhe rritjen më të shpejtë të fenomenit të dhunës online e raportojnë po shqiptarët me

12% të vajzave dhe 5% të djemve.

E vërtetë që dhuna është prezente në çdo cep të botës, diku hapur e diku e kamufluar

Me makabritete, vrasje, përdhunime, plagosje, kërcënime, abort selektiv, përndjekje, martesë në moshë të vogël, dhe diskriminim gjithëfarësoj të grave e vajzave pavarësisht pozicionit të tyre ekonomik dhe statusit të tyre shoqëror.

Por në një ditë si sot, duhet menduar pak më gjatë se dhuna nuk është hall që mund ta zgjidhin viktimat.

Duhet menduar tej mediokritetit patetik të postimeve, se si cikli i dhunës,- misogjia, tellallizimi i përditshëm se vajzat e gratë duhen parë e gjykuar siç i duan klikimet- objekte seksi dhe djemtë duhen rritur e shfaqur në rrugë, shkollë, punë e familje, siç i do zakoni, burra të fortë e hakmarrës, - përsëritet e mban nën presion breza jo vetëm individë të dhunshëm.

Dhuna është vetëm simptoma e lëngimit të shoqërisë, anemisë të sistemit ekonomik, politik dhe familjar.

Por si në metaforën e Atwood-it,: A gjë nuk ndodh menjëherë.

Në një vaskë me ujë që nxehet gradualisht, mund të valosh e të vdesësh pa e kuptuar.”